



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshor

Kryesia e Kuvendit

P-048

Prishtinë, më 8 dhjetor 2015, në orën 16:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 8 DHJETOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Slobodan Petroviq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slavko Simiq dhe Myfera Shinik.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Driton Lajçi dhe Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 23 dhe 30 nëntor 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 23 dhe 30 nëntor 2015

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 23 dhe 30 nëntor 2015.

2. Përgatitjet për seancë plenare

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se ndërkohë janë parashtruar edhe 11 pika për shqyrtim në seancë plenare.

Pastaj, kryetari e hapi diskutimin lidhur me përgatitjet për seancën plenare të radhës.

Lidhur me përgatitjet dhe mbarëvajtjen e punimeve të seancës plenare diskutuan: kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli; nënkryetarët e Kuvendit: Aida Dërguti dhe Slobodan Petroviq, si dhe Adem Grabovci, kryetar i GP të PDK-së, dhe Ismet Beqiri, kryetar i GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia e Kuvendit, me tri vota për dhe një kundër (Aida Dërguti) vendosi që seanca plenare të mbahet të hënën, më 14 dhjetor 2015, me fillim në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huas,

Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK,

8. Shqyrtimi i propozim-amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i ri-proceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës,

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive,

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për siguri në punë në veprimtarinë minerare,

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115,

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës,

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dizajnin industrial,

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore,

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e maturës shtetërore,

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit,

17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë termike,

18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,

19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,

20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës,

21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,

22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,

23. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit,

24. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE,

25. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve në Bordin e Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare - ARKEP,

26. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit,

27. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të ankesave në Komisionin e Pavarur për Media, dhe

28. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin Parlamentar.

* * *

Kryesia, gjithashtu lidhur me pikën 27 të lartshënuar nxori këtë:

Përfundim

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri më 11 dhjetor 2015, para seancës së radhës, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Ankesave në Komisionin e Pavarur për Media.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc duhet si në vijim: GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP VV, 1 anëtar; GP i AAK-së, 1 anëtar, GP Lista serbe, 1 anëtar; GP "Nisma", 1 anëtar, dhe GP "6+2", 1 anëtar.

Në fund, Kryesia, me propozim të nënkryetarit të Kuvendit, z. Sabri Hamit, vendosi që ndërkohë, nëse procedohet edhe ndonjë projektligj për shqyrtimin e dytë të radhitet në rend dite të seancës plenare, më 14 dhjetor 2015.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Njoftimi i Presidentes së Republikës së Kosovës për mbajtjen e fjalimit vjetor në Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, në pajtim me nenin 84, pika 30 të Kushtetutës, ka njoftuar se fjalimin vjetor në Kuvendin e Republikës së Kosovës do ta mbajë më 17 dhjetor 2015, në orën 11:00.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me njoftimin e Presidentes, vendosi që Kuvendi të mbajë seancë plenare më 17 dhjetor 2015, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. Adresimi i presidentes së Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

2. Kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shqyrtim me procedurë të përshpejtuar të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115

Kryesia e radhiti projektligjin e lartshënuar në rend të ditës për seancën plenare, që do të mbahet më 14 dhjetor 2015.

3. Propozim-vendimi Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Kërkohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që, në pajtim me nenin 100.4 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Kosovë, t'i caktojë tre gjykatës për anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur që do të emërohen nga Kuvendi, për përzgjedhjen e dy (2) anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

4. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e lartshënuar, nxori këtë:

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2015 sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

5. Kërkesa për emërimin e kryetarëve dhe nënkryetarëve të grupeve të miqësisë

Kryesia e shtyu pikën e lartshënuar për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

6. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për emërimin e një anëtari nga radha e GP të LS

Kryesia e shtyu pikën e lartshënuar për një mbledhje tjetër të radhës së Kryesisë së Kuvendit.

7. Kërkesa për aprovimin e shpenzimeve me rastin e pritjes së delegacionit nga Asambleja Kombëtare e Kuvajtit, prej 21-23 janar 2016

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

VENDIM

Miratohet kërkesa për mbulimin e të gjitha shpenzimet për delegacionin e Asamblesë Kombëtare të Kuvajtit, që do ta vizitojë Kuvendin e Republikës së Kosovës prej 21-23 janar 2016.

8. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtarë në Slloveni, prej 26-27 nëntor 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

VENDIM

Lejohet kompensimi i të gjitha shpenzimeve për deputeten e Kuvendit, znj. Njomza Emini, lidhur me vizitën e realizuar në Slloveni, prej datës 26-27 nëntor 2015.

9. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me vizitën e realizuar në Sofje (Bullgari), prej 6 -7 nëntor 2015

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Sofje (Bullgari), prej 6-7 nëntor 2015.

10. Njoftimi i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me vizitën e realizuar në Shqipëri, prej 17-19 nëntor 2015

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri, prej 17-19 nëntor 2015.

1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

VENDIM

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit, në këtë përbërje: Adem Grabovci, Armend Zemaj, Besim Beqaj, Flora Brovina, Slobodan Petroviq dhe Teuta Rugova për të marr pjesë në Lutjet e 64-ta të Mëngjesit, në Uashington-D.C, prej 1-5 shkurt 2016.
2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimit për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga Buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Kërkesa për mbështetje financiare për ART PROJECT

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

VENDIM

1. Lejohet pagesa në shumën prej 5 000 (pesëmijë) euro nga Buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës për mbështetje financiare për ART PROJECT.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike ‘subvencione’ dhe transferohen në xhirollogarinë PCB 1126002734000154.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 16:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale